VENDIM
Nr. 268, datë 16.5.2018

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË DEVOLL, NË NJËSINË ADMINISTRATIVE "QENDËR BILISHT", TË DISA PRONAVE ME VENDNDODHJE NË ZONAT KADASTRALE 3637 DHE 1202

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "ç", 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Devoll, në njësinë administrative "Qendër Bilisht", të pronave me numër rendor 1–4, me vendndodhje në zonat kadastrale 3637 e 1202, sipas formularit dhe lidhjes 1, bashkëlidhur këtij vendimi, për t'u përdorur për ndërtimin e një burimi gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike.

2. Bashkisë Devoll i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronave të përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Devoll për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Senida Mesi

FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

Institucioni i Pushtetit Qendror Ministria e Puneve te Brendshme
Agjencia e Inventarizimit te Prones Publike

Bashkia **DEVOLL**

Fusha e perdorimit te Prones:
per qellim te "Implementimin dhe menxhamin e projekteve gjeneruese dhe veprave ndihmese ne zonen e Devollit"

Identifikoi Bardhi KASO specialist i S.ZH.T.M.I
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Supervizoi Tatjana SPAHO, Pergjegjese e Urbanistikes
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi Bledjon NALLBATI, Kryetar i Bashkise
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

Nr. Rend	A			B			C			
	Zona Kadastr.& Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m^2)	Nga Sip Totale: Sa Ndertese (m^2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues. Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	3637	364	P.F	Tren	203 300 m2	-----	P.F	Bashkia Devoll	shtet	-----
2	3637	363	Pemishte	Tren	69 400 m2	-----	P.F	Bashkia Devoll	shtet	Kategoria VI e bonitetit
3	1202	357	P.F	Bitincke	23 800 m2	-----	P.F	Bashkia Devoll	shtet	-----
4	1202	384	P.F	Bitincke	10 300 m2	-----	P.F	Bashkia Devoll	shtet	-----

Lidhje 1

Bashkia Devoll
Njësia Administrative Qendër Bilisht

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1–4	Zhvillim ekonomik	Në pronësi